

**STATUTI**  
**I**  
**DHOMËS KOMBËTARE TË NDËRMJETËSVE**

**KREU I**  
**QËLLIMI, FORMA DHE BAZA LIGJORE, PARIMET DHE VEPRIMTARIA**

**Neni 1**  
**Qëllimi i Statutit**

1. Statuti i Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve të Republikës së Shqipërisë, përcakton rregullat për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Dhomës, marrëdhëniet midis organeve të Dhomës dhe anëtarëve të saj, mënyrën e zgjedhjes dhe funksionimit të organeve drejtuese, marrëdhëniet e Dhomës me degët vendore, si dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të shërbimit të ndërmjetësimit në Republikën e Shqipërisë, në mbështetje dhe në zbatim të ligjit nr.10385, datë 24.02.2011 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve", i ndryshuar.
2. Statuti ka qëllim garantimin dhe mirëfunksionimin e Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve, si dhe ushtrimin e profesionit të ndërmjetësit, në mënyrë të pavarur dhe me profesionalizëm, në mbështetje të ligjit dhe të parimeve të njohura në nivel kombëtar dhe atyre ndërkombëtar.

**Neni 2**  
**Forma dhe baza ligjore**

1. Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve (në vijim referuar si "DHKN") është Person Juridik i pavarur, Ent Publik, i krijuar sipas Ligjit nr.10385, datë 24.02.2011 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve", i ndryshuar (në vijim referuar edhe si "ligji për ndërmjetësimin").
2. DHKN ushtron funksionet e saj në bazë të ligjit për ndërmjetësimin, akteve nënligjore të miratuara në zbatim të tij dhe statutit të saj.
3. DHKN gëzon autonomi statutore, funksionale, organizative dhe financiare për të gjitha çështjet brenda juridiksionit të saj.
4. DHKN përfaqëson bashkimin dhe interesat e të gjithë ndërmjetësve, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 3**

**Objekti i përgjithshëm i veprimtarisë së DHKN**

Objekti i përgjithshëm i veprimtarisë së DHKN është si vijon:

1. Përfaqësimi në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare i të gjithë ndërmjetësve anëtarë të DHKN-së, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë.
2. Harmonizimi, unifikimi, përmirësimi i njohurive dhe i kapaciteteve profesionale të ndërmjetësve në Republikën e Shqipërisë me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit.
3. Promovimi i ndërmjetësimit si zgjedhje e parë ligjore e personave në konflikt ndërmjet tyre, si një shërbim i shpejtë, konfidencial dhe me kosto të ulët.
4. Sigurimi i mbrojtjes juridike për të gjithë anëtarët e Dhomës, në ofrimin dhe përmbushjen e funksioneve të tyre, për një shërbim ndërmjetësimi të pavarur, të paanshëm, profesional dhe konfidencial.
5. Përgatitja dhe nxjerrja e udhëzimeve për njësimin e praktikave dhe/ose akteve të ndërmjetësimit që janë të detyrueshme për zbatim nga ana e ndërmjetësve me qëllim unifikimin e tyre.
6. Monitorimi i zbatimit me përpikmëri të ushtrimit të detyrave dhe veprimtarisë së ndërmjetësit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, aktet nënligjore përkatëse, statutin dhe Kodin e Etikës së Ndërmjetësit.
7. Organizimi i trajnimit fillestar të kandidatëve për ndërmjetës, trajnimeve vazhduese, seminareve, takimeve mbi problematika të konstatuara gjatë procesit të ndërmjetësimit dhe zbatimit të marrëveshjes së ndërmjetësimit, promovim në të gjitha format për rritjen e përdorimit të shërbimit të ndërmjetësimit.
8. Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me dhomat ose përfaqësitë e ndërmjetësimit të shteteve të tjera si dhe ato të profesioneve të tjera të lira brenda dhe jashtë vendit, me qëllim rritjen e bashkëpunimit reciprok dhe lehtësimin e veprimtarisë së ndërmjetësve.
9. Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet publike, vendase ose të huaja, lidhur me organizimin e trajnimeve të përbashkëta ose specifike mbi veprimtarinë e ndërmjetësimit, si dhe në angazhimin e këtyre të fundit në përdorimin e ndërmjetësimit si mjet e zgjedhje e parë në lidhje me konfliktet ku janë palë.
10. Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe financimit me organizata, qendra, shoqata vendase e të huaja për organizimin e seminareve, trajnimeve, aktiviteteve ndërgjegjësuese në fushën e ndërmjetësimit.
11. Bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë, për planifikimin, organizimin dhe monitorimin e procesit të trajnimit fillestar dhe vazhdues, nëpërmjet propozimit të rregullave për përzgjedhjen e trajnerëve, trajnimin e trajnerëve, vlerësimin e performancës së tyre, organizimin dhe vlerësimin e provimit kualifikues për marrjen e licencës së ndërmjetësit, si dhe për hartimin e miratimin e akteve dhe politikave të përbashkëta sektoriale në fushën e ndërmjetësimit, sipas kuadrit ligjor .
12. Çdo funksion tjetër të parashikuar nga ligji për ndërmjetësimin dhe/ose çdo akt tjetër nënligjor të miratuar në zbatim të tij.
13. Siguron dhe përpunon të dhëna statistikore mbi shërbimin e ndërmjetësimit dhe rasteve të referuara në ndërmjetësim nëpërmjet platformës të bazës së të dhënave (data base).

**KREU III**  
**ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E DHOMËS KOMBËTARE TË NDËRMJETËSIMIT**

**Neni 8**  
**Organizimi i DHKN-së**

DHKN është e organizuar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke bashkërenduar veprimtarinë e saj me degët vendore. Këto të fundit, nuk kanë personalitet juridik të vetin, por varen nga DHKN dhe bashkërendojnë veprimtarinë e tyre me këtë të fundit.

**Neni 9**  
**Organet e DHKN-së**

1. Organet vendimmarrëse të DHKN janë:
  - a) Mbledhja e Përgjithshme e Ndërmjetësve;
  - b) Këshilli Drejtues;
  - c) Kryetari;
2. Organ mbikqyrëse i veprimtarisë së ndërmjetësve:
  - a) Bordi Disiplinor

**Neni 10**

**Mbledhja e Përgjithshme e Ndërmjetësve**

1. Mbledhja e Përgjithshme e Ndërmjetësve është organi më i lartë vendimmarrës i DHKN-së. Ajo përbëhet nga tërësia e të gjithë anëtarëve të DHKN-së dhe drejtohet si rregull nga Kryetari. Në mungesë të Kryetarit, mbledhja drejtohet nga një prej anëtarëve të Këshillit Drejtues të autorizuar nga Kryetari.
2. Mbledhja e Përgjithshme e Ndërmjetësve asistohet nga Stafi mbështetës, i cili ka funksione ndihmëse dhe mbështetëse.
3. Mbledhja e Përgjithshme e Ndërmjetësve mbledhet nën drejtimin e Kryetarit të Dhomës në seanca të rregullta, jo më pak se një herë në vit, e cila i njoftohet anëtarëve të Mbledhjes të paktën 30 ditë kalendarike para çdo mbledhjeje.
4. Kanë të drejtë të thërrasin Mbledhjen e Përgjithshme:
  - a. Kryetari i DHKN-së,
  - b. 1/3-ta e anëtarëve të Këshillit Drejtues,
  - c. 2/3-ta e anëtarëve të Mbledhjes së Përgjithshme të Ndërmjetësve,
5. Autoriteti i cili propozon thirrjen e Mbledhjes, propozon edhe rendin e ditës për atë Mbledhje.
6. Mbledhja është e vlefshme kur në të marrin pjesë më shumë se 50%+1 e të gjithë anëtarëve të DHKN-së. Nëse nuk plotësohet kuorumi i nevojshëm, Këshilli Drejtues i DHKN-së vendos brenda 30 ditëve për datën e mbledhjes së ardhshme. Nëse në mbledhjen e radhës nuk plotësohet kuorumi i sipërpërmendur, për mbledhjen e radhës dhe zhvillohet kur është prezent 50%+1 anetar i saj.

7. Mbledhjet drejtohen nga Kryetari i DHKN-se, në mungese të tij nga një prej antarëve të Këshillit Drejtues, të autorizuar nga Kryetari.
8. Rendi i ditës dhe materialet shpjeguese duhet t'u njoftohen të gjithë anëtarëve të paktën 7 ditë kalendarike para datës kur do të zhvillohet Mbledhja. Ky njoftim do të realizohet nëpërmjet adresave email të deklaruara prej anëtarëve në regjistrin që administron DHKN ( preferohen adresat me dhkn.gov.al ).

**Neni 11**  
**Kompetencat e Mbledhjes së Përgjithshme të Ndërmjetësve**

Mbledhja e Përgjithshme e Ndërmjetësve ka këto kompetenca:

1. Vendos politikat kryesore të veprimtarisë së DHKN-së.
2. Shqyrton dhe miraton Statutin, Rregulloren dhe Kodin e Etikës së Ndërmjetësit, si dhe akte të tjera të saj.
3. Emëron dhe shkarkon anëtarët e Këshillit Drejtues, Kryetarin e DHKN-së si dhe 4 anëtarët e Bordit Disiplinor, qe zgjidhen nga kjo Mbledhje.
4. Miraton të gjitha aktet e krijimit/shuarjes, organizimit dhe funksionimit të Degëve Vendore të DHKN-së;
5. Shqyrton dhe miraton pasqyrat financiare, buxhetin dhe raportin vjetor të veprimtarisë së DHKN-së të përgatitur nga Këshilli Drejtues.
6. Miraton fondet e nevojshme shtesë, për funksionimin dhe realizimin e qëllimeve të veprimtarive të Dhomës, të propozuar nga Këshilli Drejtues.
7. I propozon Ministrin të Drejtësisë për miratim programin e trajnimit fillestar, rregulloren e trajnimit fillestar dhe programin e trajnimit vazhdues.
8. I propozon Ministrin të Drejtësisë për miratim programin e trajnimit dhe rregullat për përzgjedhjen e trajnerëve dhe vlerësimin e performancës së tyre.
9. I propozon Ministrin të Drejtësisë për miratim rregullat për organizimin dhe vlerësimin e provimit kualifikues.
10. I propozon Ministrin të Drejtësisë për miratim drat-udhezimin për Tarifat dhe për ndryshimet Ligjore
11. Vendos për çështje të tjera që lidhen me profesionin e ndërmjetësit dhe aktivitetin e DHKN.
12. Çdo kompetencë tjetër të parashikuar në akte ligjore, nënligjore si dhe në këtë Statut.

**Neni 12**

**Mekanizmi i votimit dhe vlefshmëria e vendimeve**

1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara ndryshe në ligj apo në këtë statut, vendimet e Mbledhjes së Përgjithshme të Ndërmjetësve konsiderohen të vlefshme kur merren me shumicën e thjeshtë, të anëtarëve të pranishëm në Mbledhje.
2. Vendimet për miratimin dhe ndryshimin e Statutit, Rregullores së DHKN-së dhe Kodit të Etikës së Ndërmjetësit, janë të vlefshme kur në mbledhje marrin pjesë më shumë se 50% e anëtarëve të DHKN dhe votojnë pro të paktën 2/3-at e anëtarëve të pranishëm
3. Çdo anëtar gëzon të drejtën e një vote sipas parashikimeve të këtij Statuti. E drejta e votës ushtrohet personalisht, pa u deleguar në asnjë rast me akt përfaqësimi.
4. Vendimmarrjet realizohen me votim të hapur, me ngritje dore ose kartoni nga secili anëtar.
5. Komisioni për procedurat e votimit, organizon dhe shpall publikisht rezultatin e votimit. Komisioni i votimit është përgjegjës për mbajtjen e procesverbaleve, të Mbledhjes dhe procesit të votimit.
6. Vendimet regjistrohen në një regjistër që mbahet nga Kryetari i Dhomës

**Neni 13**

**Këshilli Drejtues**

1. Këshilli Drejtues është organ kolegjal, vendimmarrës dhe ekzekutiv që përbëhet nga shtatë anëtarë.
2. Gjashtë anëtarë të Këshillit Drejtues zgjidhen nga Mbledhja e Përgjithshme e Ndërmjetësve me një mandat 3 vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje, ndërsa anëtari i shtatë është Kryetari i DHKN.
3. Anëtarë të Këshillit Drejtues zgjidhen anëtarët më të votuar midis kandidatëve konkurrues, ish kryetari është anëtar pa votuar.
4. Mbledhjet e Këshillit Drejtues drejtohen nga Kryetari i DHKN-së ose në mungesë të tij nga anëtari më i vjetër në moshë.
5. Pranë Këshillit Drejtues, fitohet të marrin pjesë në mbledhje (pa të drejtë vote) edhe Kryetarët e Nderit, të cilët kontribuojnë në nivel këshillimor për çështje të rëndësishme të lidhura me veprimtarinë e ndërmjetësimit.

**Neni 14**

**Kompetencat e Këshillit Drejtues**

Këshilli Drejtues i DHKN-se, në ushtrimin e funksioneve të tij organizative e vendimmarrëse ka këto kompetenca:

1. Siguron zbatimin e vendimeve të organeve të DHKN-së.
2. Propozon politikat kryesore te veprimtarisë së DHKN-së.
3. Propozon amendimet mbi aktet ligjore dhe nënligjore.

4. Përgatit draftregulloret si dhe çdo akt që i paraqitet për miratim Mbledhjes së Përgjithshme të Ndërmjetësve.
5. Miraton strukturën administrative mbështetëse të DHKN-së dhe funksionet përkatëse.
6. Përgatit dhe i propozon Ministrit të Drejtësisë, për miratim rregulla të hollësishme mbi kohëzgjatjen, përmbajtjen dhe organizimin e trajnimit fillestar dhe vazhdues, përzgjedhjen e trajnerëve, trajnimin e trajnerëve, vlerësimin e performancës së tyre, organizimin dhe vlerësimin e provimit kualifikues si dhe rregullat për certifikimin e të gjithë programeve
7. Propozon dhe miraton programe të trajnimit për formime të specializuara dhe / ose profesionale si dhe rregullat për përzgjedhjen e trajnerëve dhe vlerësimin e tyre.
8. Miraton logon dhe vulën e DHKN-së.
9. Krijon grupe pune për kryerjen e detyrave specifike, me karakter të përhershëm ose të përkohshëm, me rol rekomandues ose propozues dhe struktura të veçanta ndihmëse në funksion të realizimit të kompetencave të tij.
10. Harton buxhetin, raportin vjetor të punës dhe të aktiviteteve që i paraqiten Mbledhjes së Përgjithshme të Ndërmjetësve.
11. Miraton ekspertin(ët) kontabël të regjistruar, ose shoqëri auditimi të licencuara në fushën përkatëse, për auditimin e llogarive vjetore dhe përgatitjen e pasqyrave financiare.
12. Vendos për kuotën e përvitshme të anëtarësimit në DHKN.
13. Propozon rregullat për tarifën e shpërblimit për punën e ndërmjetësit dhe ia përcjell ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave për miratim.
14. Harton përmbajtjen e kartës vjetore të antarësisë së ndërmjetësit.
15. Propozon rregullat për përjashtimin/uljen e tarifës së ndërmjetësit për kategorinë e personave në nevojë, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
16. Miraton shpërblimin për anëtarët e bordeve, komisioneve, organeve ndihmëse të krijuara në bazë të ligjit për ndërmjetësimin dhe këtij Statuti;
17. Zgjedh anëtarët e Komisionit Vlerësues të aplikantëve që kanë përfunduar Programin e Detyrueshëm të Formimit Fillestar, sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin për ndërmjetësimin dhe në këtë Statut.
18. Miraton unifikimin e Tipit të Akt- Marreveshjeve dhe Arkives së DHKN
19. Cakton personin për administrim të mbledhjes dhe perpunimin e të dhënave statistikore ( date-base ) për rastet e referuara në ndërmjetësim
20. Çdo kompetencë tjetër që i buron nga ligji, Statuti dhe që nuk bie në kundërshtim me kompetencat e Mbledhjes së Përgjithshme të Ndërmjetësve ose Kryetarit të DHKN.

**Neni 15**  
**Organizimi i Këshillit Drejtues**

1. Këshilli i Drejtues drejtohet dhe përfaqësohet nga kryetari i DHKN dhe, në rast pamundësie, nga anëtari më i vjetër në moshë.
2. Këshilli Drejtues mbledhet të paktën 4 herë në vit ose sa herë që e kërkon Kryetari i DHKN-së apo 1/3 e anëtarëve të saj.

3. Mbledhja e Këshillit Drejtues është e vlefshme kur në të marrin pjesë më shumë se gjysma e numrit të anëtarëve të tij.
4. Vendimet e Këshillit Drejtues merren me shumice të thjeshtë të të gjithë anëtarëve pjesëmarrës në mbledhjen e Këshillit, jane te vlefshme dhe votimet on-line.
5. Këshilli Drejtues mund të ftojë në mbledhjet e tij çdo subjekt të interesuar, ose që ka lidhje me çështjen që shqyrtohet.
6. Njoftimi dhe dërgimi i materialeve pjesë e rendit të ditës së mbledhjes së radhës së Këshillit, behet të paktën 5 ditë kalendarike përpara datës së caktuar për mbledhje. Njoftimi do të realizohet nëpërmjet, adresave të tyre elektronike.
7. Në mbledhjen e radhës të Këshillit Drejtues diskutohen çështjet në rend dite të njoftuara paraprakisht, si dhe çdo çështje tjetër të propozuar nga të paktën 1/3 e anëtarëve të pranishëm.
8. Kryetari i DHKN ka të drejtë të përfshijë në rendin e ditës edhe çështje të tjera nëse janë të pranishëm të gjithë anëtarët.
9. Mbledhjet e Këshillit Drejtues zbardhen në procesverbalin përkatës të mbledhjes, i cili mbahet nga njëri nga anëtarët e Këshillit, ose nga një prej anëtarëve të stafit mbështetës dhe nënshkruhet prej anëtarëve të pranishëm.
10. Mbledhjet e jashtëzakonshme mund të organizohen e realizohen edhe nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik, me detyrimin e vetëm që një gjë e tillë të jetë njoftuar më parë, dhe mjetet e komunikimit elektronik të jenë të tilla që të sigurojnë identifikimin e qartë të anëtarëve dhe votën e tyre.
11. Të gjitha komunikimet, vendimet dhe aktet e tjera të miratuara nga Këshilli zbardhen dhe nënshkruhen nga Kryetari i Dhomës.

#### Neni 16

#### Anëtari i Këshillit Drejtues

1. Çdo anëtar i DHKN-së ka të drejtë të kandidojë për t'u zgjedhur anëtar i Këshillit Drejtues.
2. Antarët e Këshillit Drejtues zgjidhen për një mandat 3-vjeçar me te drejte rizgjedhje, nga rradhët e anëtarëve që nuk kanë masa disiplinore në tre vitet e fundit.
3. Anëtarit të Këshillit të Drejtues i përfundon mandati:
  - a) me mbarimin e afatit;
  - b) me dorëheqje;
  - c) kur humbet cilësinë si anëtar i DHKN;
  - d) në rastet e pamundësisë për të kryer detyrën.
4. Në rast mbarimi të parakohshëm të mandatit të anëtarit, mandati i anëtarit të ri të zgjedhur është plotësues.

5. Çdo anëtar që kryen shkelje të ligjit të ndërmjetësimit, dispozitave të këtij Statuti, Rregullores, Kodit të Etikës së Ndërmjetësit, vendimeve të Mbledhjes së Përgjithshme të Ndërmjetësve, në rastet e pamundësisë për të kryer detyrën ose nëse mungon 3 herë radhazi pa arsye në mbledhjet e njoftuara të Këshillit Drejtues, bëhet subjekt i një mocioni mosbesimi.
6. Mocioni i mosbesimit duhet të nënshkruhet nga më shumë se 1/2 e anëtarëve të Këshillit Drejtues, ose 2/3 e anëtarëve të DHKN-se. Në rast mocioni mosbesimi, anëtari ndaj të cilit mbahet mocioni, nuk ka të drejtë vote.
7. Shkarkimi vendoset nga Mbledhja e Përgjithshme e Ndërmjetësve me 50% +1 të votave të anëtarëve të pranishëm.

**Neni 17**  
**Kryetari i DHKN**

1. Kryetari i DHKN përfaqëson DHKN-në në marrëdhëniet me të tretët, brenda ose jashtë vendit.
2. Kryetari zgjidhet nga antarëve të Mbledhjes së Përgjithshme të Dhomës, me votim, për një mandat 4-vjeçar, me të drejtë rizgjedhje një herë.
3. Kryetar zgjidhet kandidati më i votuar në procesin e konkurrimit.
4. Kryetari është automatikisht edhe anëtar i Këshillit Drejtues.

**Neni 18**  
**Kriteret për kandidimin për Kryetar të DHKN**

Kryetar i DHKN-së mund të zgjidhet çdo ndërmjetës i cili plotëson kriteret e mëposhtme:

1. Të ketë eksperiencë në ushtrimin e profesionit të ndërmjetësit jo më pak se 5 vjet.
2. Të jetë person me integritet të lartë moral dhe profesional.
3. Të zotërojë aftësi menaxhuese dhe komunikuese.
4. Të mos ketë patur ndonjëherë masa administrative/disiplinore në ngarkim të tij.
5. Të mos jetë i dënuar sipas një vendimi gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

**Neni 19**  
**Kompetencat e Kryetarit**

Kryetari i DHKN-së ka përgjegjësitë e mëposhtme:

1. drejton, organizon punën dhe është përgjegjës për ecurinë normale të veprimtarisë së DHKN-së;
2. përfaqëson DHKN-në në marrëdhënie me të tretët;
3. thërret dhe drejton mbledhjet e Këshillit Drejtues;
4. zbaton planin e punës të DHKN-së, të miratuara nga Këshilli Drejtues;

5. nënshkruan të gjitha aktet e DHKN;
6. nënshkruan marrëveshje me palë të treta vendase dhe të huaja në emër dhe për llogari të DHKN-së.
7. kryen funksionin promovues dhe ndërgjegjësues për çështje me rëndësi të veçantë në fushën e ndërmjetësimit;
8. delegon me shkrim funksionin e përfaqësimit të DHKN në marrëdhënie me të tretët;
9. siguron mirëfunksionimin administrativ e financiar të aktivitetit të DHKN;
10. luan rol aktiv në përfaqësimin dhe promovimin e interesave të fushës së ndërmjetësimit dhe informimin e publikut nëpërmjet mediave të shkruara dhe elektronike lidhur me procesin e ndërmjetësimit, në raport me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e ndërmjetësimit;
11. propozon stafin mbështetës të DHKN për miratim nga Këshilli Drejtues;
12. propozon projekt-rregullore dhe akte të tjera për funksionimin e DHKN të cilat i miraton Këshilli Drejtues;
13. kontrollon dhe mbikëqyr administrimin e shpenzimeve brenda kufijve të buxhetit të DHKN.


#### Neni 20

#### Përfundimi i mandatit të Kryetarit

1. Kryetarit i mbaron mandati ditën kur mbushen 4 vjet nga zgjedhja e tij.
2. Kryetari qëndron në detyrë deri në momentin e zëvendësimit nga kryetari i ri i zgjedhur sipas ligjit për ndërmjetësimin dhe dispozitave të këtij Statuti, përveç rasteve të përcaktuara në pikën katër të këtij neni.
3. Në rastet kur mandati i Kryetarit ndërpritet sipas pikës katër të këtij neni kompetencat e Kryetarit do ushtrohen nga anëtari më i vjetër i Këshillit Drejtues.
4. Mandati i Kryetarit mund të ndërpritet edhe para mbarimit të afatit për të cilin është emëruar, në këto raste:
  - a. jep dorëheqjen;
  - b. humbet zotësinë për të vepruar;
  - c. në rast se për më shumë se 6 muaj të pandërprerë nuk është në gjendje të ushtrojë këtë funksion.

Konstatimi i pamundësisë për ushtrimin e funksionit realizohet nga Këshilli i Drejtues i cili vendos për këtë rast me shumicën e të gjithë anëtarëve të tij. Kryetari në këtë rast nuk merr pjesë në procesin e votimit.

5. Me ndërprerjen e parakohshme të mandatit të Kryetarit ose me konstatimin e pamundësisë së këtij të fundit për të ushtruar funksionin, Këshilli Drejtues fillon menjëherë procedurat për thirrjen e Mbledhjes së Përgjithshme të Anëtarëve, me qëllim shkarkimin dhe/ose zgjedhjen e Kryetarit të ri të DHKN.



### Neni 21 Shkarkimi i Kryetarit

1. Shkarkimi i kryetarit të DHKN-së realizohet nga Mbledhja e Përgjithshme e Ndërmjetësve, në rastet kur:
  - a. kryetari dënohet me vendim penal të formës së prerë;
  - b. kryetari kryen veprime të cilat bien ndesh me dispozitat ligjore dhe statutore, si dhe me vendimet e Mbledhjes së Përgjithshme të Ndërmjetësve dhe Këshillit Drejtues të DHKN;
2. Për rastin e parashikuar në pikën 1/a.), shkarkimi është i vlefshëm automatikisht mbi bazën e një vendimi gjyqësor të formës së prerë.
3. Për rastin e parashikuar në pikën 1/b.), propozimi për shkarkimin e kryetarit duhet të bëhet minimumi nga 2/3 e anëtarëve në mbledhjen e përgjithshme të DHKN.
4. Vendimmarrja për shkarkimin e kryetarit në rastin e parashikuar në pikën 1/b.) të këtij neni realizohet me votimin pro shkarkimit, të jo më pak se 2/3-ve të anëtarëve në Mbledhjen e Përgjithshme.

### Neni 22 Bordi Disiplinor

1. Bordi Disiplinor është organ kolegjal që përbëhet nga pesë anëtarë dhe ka detyrë të sigurojë dhe të garantojë palët për një proces të ndershëm, transparent dhe të paanshëm si dhe të pasqyrojë integritetin moral dhe profesional në shqyrtimin e çështjes.
2. Katër anëtarë të Bordit Disiplinor zgjidhen nga Mbledhja e Përgjithshme e Ndërmjetësve, ndërsa anëtari i pestë zgjidhet nga Ministri i Drejtësisë. Mandati i tyre është 5 vjeçar.
3. Anëtarë të Bordit Disiplinor zgjidhen anëtarët më të votuar midis kandidatëve konkurrues.
4. Çdo anëtar gëzon të drejtën e një vote sipas parashikimeve të këtij Statuti. E drejta e votës ushtrohet personalisht, pa u deleguar në asnjë rast me akt përfaqësimi.
5. Si rregull vendimmarrjet realizohen me votim të hapur, me ngritje dore ose kartoni nga secili anëtar. Bordi Disiplinor vendos me shumicën e votave të anëtarëve me të drejtë vote.
6. Procesi i votimit nuk është i vlefshëm nëse marrin pjesë më pak se gjysma e anëtarëve.
7. Rregulla të tjera të funksionimit të Bordit Disiplinor, janë të detajuara në "Regulloren e Bordit Disiplinor" e cila është miratuar nga Mbledhja e Përgjithshme e Ndërmjetësve në formën e një shtojcë që i bashkëlidhet këtij statuti.

### Neni 23 Anëtari i DHKN

1. Anëtar i DHKN-së është çdo ndërmjetës i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, i regjistruar në Regjistrin e Ndërmjetësve pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe pagues i rregullt i tarifës vjetore përkatëse.



2. Çdo anëtar i DHKN-së ushtron të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi, Statuti i DHKN-së, Kodi i Etikës së Ndërmjetësit dhe Rregulloret.
3. Çdo person juridik ose fizik ofruer i shërbimit të ndërmjetësimit është i detyruar të raportojë të dhëna statistikore për çështjet e trajtuara sipas udhëzimeve të Këshillit Drejtues.

#### Neni 24

#### Të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve të DHKN

1. Anëtarët e DHKN gëzojnë të drejta dhe detyrime të barabarta.
2. Anëtarët e DHKN kanë të drejtë të informohen në lidhje me të gjitha aktet e miratuara nga organet vendimmarrëse të DHKN.
3. Anëtarët e DHKN gëzojnë të drejtën të marrin informacion, shpjegime dhe sqarime ligjore për të gjitha çështjet apo problematikat që ata kanë hasur gjatë ushtrimit të detyrës së tyre.
4. Anëtarët e DHKN kanë të drejtë të kërkojnë mbështetjen juridike të DHKN për të gjitha çështjet dhe problematikat me të cilat do të duhet të përballen në institucionet publike dhe private, si dhe për çdo pengesë në ushtrimin e funksionit të tyre.
5. Anëtarët e DHKN zbatojnë legjislacionin në fuqi dhe të gjitha aktet juridike në fushën e ndërmjetësimit, të miratuara nga institucionet shtetërore dhe nga çdo organ i DHKN, si dhe rregullat e përcaktuara në këtë Statut.
6. Anëtarët mbajnë përgjegjësi ligjore personale në lidhje me ushtrimin e detyrës së ndërmjetësit.
7. Anëtarit të DHKN që për shkak të një detyrë tjetër, publike/shtetërore, nuk i lejohet shprehimisht të ushtrojë të drejtën e profesionit të ndërmjetësit, i garantohet e drejta e titullit të licensuar, sipas kriterëve ligjore. Në këto raste anëtari i DHKN humbet të drejtën e kthimit të kuotës së parapaguar.
8. Anëtarët e DHKN kanë detyrimin për të kryer pagesën vjetore të anëtarësisë pranë DHKN. Vlera e pagesës vjetore të anëtarësisë miratohet me shumicë të thjeshtë të Këshillit të Drejtues, dhe i njoftohet çdo ndërmjetësi.
9. Veprimtaria e anëtarëve të DHKN-së, në cilësinë e tyre si ndërmjetës, i nënshtrohet kontrollit për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore nga Ministria e Drejtësisë.

#### Neni 25

#### Stafi mbështetës i DHKN

1. Stafi mbështetës i DHKN, propozohet nga Kryetari i DHKN në bazë të nevojave dhe mundësisë së dhomës.
2. Anëtarët e stafit mbështetës zgjidhen nga Këshilli i Drejtues, me propozim të Kryetarit të Dhomës.
3. Detyrat e stafit mbështetës propozohen nga Kryetari i DHKN dhe miratohen nga Këshilli Drejtues.

**KREU IV**  
**DEGËT VENDORE TË NDËRMJETËSIMIT**

**Neni 26**

**Degët Vendore të Ndërmjetësimit**

1. Degët vendore krijohen në bazë të ligjit për ndërmjetësimin dhe sipas rregullave të përcaktuara nga Mbledhja e Përgjithshme e Ndërmjetësve për këtë qellim. Degët Vendore krijohen mbi bazë Qarku sipas ndarjes administrative në Republikën e Shqipërisë.
2. Numri minimal i ndërmjetësve që mund të formojnë një degë vendore ndërmjetësimi është 5 ndërmjetës, anëtarë të DHKN-së. Anëtarët e një dege vendore vendosin me shumicë të thjeshtë Kryetarin e Degës.
3. Çdo anëtar i DHKN mund të jetë anëtar vetëm i një dege vendore.
4. Degët vendore ushtrojnë aktivitete ndërgjegjëse dhe promovuese të veprimtarisë të ndërmjetësimit.
5. Degët vendore raportojnë në mënyrë periodike pranë DHKN-së mbi aktivitetin e ushtruar.

**KREU V**  
**REGJISTRIMI DHE TRAJNIMI I NDËRMJETËSVE**

**Neni 27**

**Regjistri i DHKN-së**

1. DHKN mban dhe administron Regjistrin e Anëtarësisë, ku përcaktohen këto të dhëna:
  - a. identiteti, vendbanimi, numri i licencës, data e fillimit të veprimtarisë së ndërmjetësit dhe adresa e vendit ku zhvillohet veprimtaria e ndërmjetësit, dega vendore të cilës i përket në rastin e personave fizikë;
  - b. emërtimi, selia e shoqërisë, emrin e administratorit dhe emrat e ndërmjetësve të punësuar në shoqëri, numrin dhe datën e licencës, adresën elektronike, nr e kontaktit, adresën e zyrës së ndërmjetësimit, dega vendore të cilës i përket në rastin e personave juridike;
  - c. një rubrikë e veçantë për çdo ndërmjetës mbi kuotizacionet e derdhura, trajnimet e kryera si dhe të dhëna të tjera të nevojshme. Rregullat e hollësishme për mbajtjen e këtij regjistri miratohen nga Këshilli Drejtues, ndërsa administrimi i tij bëhet nga Kryetari.
2. Regjistri përditësohet vazhdimisht me të dhënat e kërkuara. DHKN-ja kujdeset që listat e Ndërmjetësve të afishohen pranë degëve vendore të ndërmjetësimit gjykatës dhe institucioneve të tjera.

**Neni 28**

**Trajnimi**

1. DHKN përgatit, të paktën një herë në vit, një program trajnimi të detyrueshëm për të gjithë ndërmjetësit e sapo regjistruar pranë Regjistrat të Ndërmjetësve, si dhe mundëson e kujdeset për trajnimin në vazhdimësi të ndërmjetësve.
2. Këshilli Drejtues përgatit dhe i propozon Ministrit të Drejtësisë për miratim rregulla të hollësishme mbi kohëzgjatjen, përmbajtjen dhe organizimin e trajnimit fillestar dhe vazhdues, përzgjedhjen e trajnerëve, trajnimin e trajnerëve, vlerësimin e performancës së tyre, organizimin dhe vlerësimin e provimit kualifikues si dhe rregullat për certifikimin e të gjithë programeve.

**KREU VI**  
**TË ADHURAT E DHKN-së**

**Neni 29**

**Burimi i të ardhurave dhe shfrytëzimi i tyre**

1. DHKN siguron të ardhura nga kuotizacioni vjetor i anëtarëve të saj, nga sponsorizime, donacione, projekte dhe të ardhura nga forma të tjera në përputhje me këtë statut dhe legjislacionin në fuqi. Të gjitha të ardhurat, pavarësisht burimit, përdoren për përballimin e shpenzimeve dhe arritjen e objektivave të DHKN, si dhe ushtrimin e vijimit normal të veprimtarisë në përputhje me ligjin për ndërmjetësimin dhe këtë statut.
2. DHKN mund të fitojë pronësi mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, të cilat regjistrohen në emër të saj dhe admistrohen për interesat e DHKN.
3. DHKN nuk shpërndan fitime.

**Neni 30**

**Kuotizacioni vjetor**

1. Vlera e kuotës vjetore të anëtarit të DHKN vendoset nga Këshilli Drejtues.
2. Çdo anëtar i DHKN-së është i detyruar të paguajë kuotën vjetore të anëtarësisë.
3. Pagesa e kuotës vjetore realizohet brenda muajit janar të çdo viti duke u kredituar në llogarinë bankare të DHKN-së ose duke u pajisur me mandat pagese pranë DHKN sipas njoftimit përkatës. Pagesa e kuotës vjetore është kusht për marrjen e kartës vjetore të anëtarësisë.



**Neni 31**  
**Administrimi i të ardhurave**

1. Administrimi i të ardhurave dhe buxhetit të DHKN-së bëhet nga Këshilli Drejtues.
2. Për auditimin periodik të pasqyrave financiare të DHKN-së caktohet një/disa ekspert/e kontabël me licencë ne fushën përkatëse.

**KREU VII**  
**TE NDRYSHME**

**Neni 32**  
**Ndërmjetësi i huaj**

1. Ndërmjetësi i huaj që dëshiron të bëhet anëtar i DHKN-së duhet të plotësojë të njëjtat kritere si ndërmjetësi vendas.
2. Rregullat dhe procedurat për njohjen e titullit ndërmjetës të fituar në një shtet të huaj përcaktohet me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë apo akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.



**Neni 33**  
**Mbarimi i mandatit të organeve drejtuese të DHKN**



1. Mandati i përfunduar i organeve drejtuese vazhdon deri në caktimin e personave zëvendësues.
2. Anëtarët e organeve të DHKN-së edhe pas përfundimit të mandatit, janë të detyruar të ruajnë me konfidencialitet të plotë çështjet e trajtuara, diskutuara, vendosura, korrespondencën për të cilat ata vihen ne dijeni për shkak të detyrës.

**Neni 34**  
**Përgjegjësia e DHKN-së dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. DHKN është e përjashtuar nga çdo përgjegjësi për pasojat e veprimeve a mosveprimeve të çdo ndërmjetësi para, gjatë apo pas përfundimit të procedurës së ndërmjetësimit.
2. Mosmarrëveshjet e mundshme zgjidhen me mirëkuptim. Kur kjo nuk arrihet, mosmarrëveshja zgjidhet me ndërmjetësim ose palët i drejtohen gjykatës kompetente sipas rastit.

**Neni 35**  
**Dispozita përfundimtare**

Për të gjitha çështjet që nuk janë trajtuar nga ky Statut, do të aplikohen dispozitat ligjore të ligjit për ndërmjetësimin dhe çdo akt tjetër ligjor apo nënligjor rregullues në fuqi.





**Neni 36**  
**Shfuqizime**











1. Me hyrjen në fuqi të këtij statuti, shfuqizohet statuti i DHKN-së i miratur më datë 07.07.2013.
2. Aktet e nxjerra sipas statutit ende në fuqi nëse nuk janë në kundërshtim me statutin e ri, mbeten në fuqi deri në miratimin e akteve të reja.



**Neni 37**

**Hyrja në fuqi**

1. Statuti hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Mbledhja e Përgjithshme e Ndërmjetësve të DHKN-së.
2. Ky Statut u miratua me Vendimin nr. 12, datë 25/12/22 të Mbledhjes së Përgjithshme të Ndërmjetësve të DHKN.



Kristine Marjan  
Arbi Zohir

Mimosa Sasa

Rita Fyrbom

MORIKIYU TOICHI  
Suzela Mueli

Tomoda Zheraj  
Bukeme Sketub

Alma Alky's Ay.

Eva Sepdron  
Lela Sun

Genitona Ouedis

Enkeleza Gode

Dito Adyeli